



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian
Directory for Economy, Development, Tourism and European Integrations



RAPORTI I PUNËS

(Janar 2024 - Dhjetor 2024)

Mitrovicë, 2024

Fjala e Drejtorit

Kam pasur nderin dhe përgjegjësinë për të menaxhuar drejtorinë e Ekonomisë, Zhvillimit dhe Turizmit, me vullnetin për të shërbyer qytetin dhe qytetarët e Mitrovicës.

Në programin tonë qeverisës 2022-2025, prioriteti qendror ka qenë dhe mbetet zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm dhe punësimi. Që nga momenti i marrjes së mandatit, kemi analizuar organizimin e brendshëm të komunës dhe kemi identifikuar nevojën e fuqizimit të dikasterit të zhvillimit ekonomik. Turizmi është vendosur si një fushë me potencial të madh në Mitrovicë, duke krijuar një drejtori të re për mbulimin e këtyre fushave të lëna në harresë.

Në vitin 2024, Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm u angazhua në krijimin e një ambienti të favorshëm për bizneset dhe në forcimin e mekanizmave të zhvillimit ekonomik lokal, si dhe promovimin e turizmit lokal.

Raporti im përqendrohet në pesë objektiva kryesore, të cilat ishin në fokus të udhëheqjes gjatë vitit 2024:

1. Fuqizimi i rolit të komunës në zhvillimin ekonomik dhe zhvillimin e turizmit;
2. Promovimi i bizneseve dhe vendeve të punës;
3. Promovimi dhe fuqizim i turizmit lokal;
4. Ofrimi i përkrahjes për biznese fillestare dhe atyre ekzistuese;
5. Funksionalizimi i zonave ekonomike dhe ofrimi i kushteve të bërit biznes;

I juaji,

Elvis FEKA

Drejtore për Ekonomi, Zhvillim,

Turizëm dhe Integrime Evropiane



Detyrat dhe përgjegjësit e drejtorisë

1. Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian do të jetë përgjegjëse për kryerjen e detyrave si në vijim:
 - 1.1. Harton politika dhe programe për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të Komunës dhe tërheqjen e investimeve për zhvillim ekonomik;
 - 1.2. Hartimin e planit për shfrytëzimin e burimeve ekonomike që janë brenda Komunës, në kuadër të përgjegjësisë së saj;
 - 1.3. Përgatitë projekt propozime për zhvillim ekonomik lokal dhe hulumton, identifikon fonde nga burime të ndryshme për realizimin e projekteve;
 - 1.4. Zbaton politikat dhe planet e aprovuara në fushën e zhvillimit ekonomik të Komunës dhe sugjeron masa për avancimin e tyre;
 - 1.5. Udhëheq dhe bashkërendon proceset e planifikimit strategjik për zhvillim ekonomik.
 - 1.6. Përcjellë ecuritë ekonomike sipas sektorëve në përgjithësi dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në veçanti;
 - 1.7. Grumbullon dhe përpunon të dhëna statistikore për bizneset, resurset njerëzore dhe natyrore me rëndësi për hartimin e informacioneve, analizave planeve dhe programeve për zhvillim të Komunës;
 - 1.8. Bënë promovimin e resurseve zhvillimore të Komunës përmes broshurave, buletineve, panairëve dhe organizimeve tjera;
 - 1.9. Hulumton dhe identifikon projektet dhe koordinon punët rreth partneritetit publiko privat;
 - 1.10. Mban kontakte me donatorë, komunitetin e biznesit dhe bashkatdhetarët që jetojnë në botën e jashtme për krijimin e kushteve për investime në Komunë;
 - 1.11. Organizon programe trajnuese dhe ri-kualifikuese si dhe asistencë teknike për bizneset e reja;
 - 1.12. Bënë regjistrimin, ndryshimin e veprimtarisë dhe çregjistrimin e bizneseve dhe mban data bazë për numrin, strukturën dhe selinë e bizneseve;
 - 1.13. Zbaton politikat e përcaktuara dhe aktet normative nga fushë veprimtaria e Komunës në lëmin e zhvillimit dhe planifikimit;
 - 1.14. Bashkëpunon dhe koordinon punët dhe aktivitetet me ministrinë e linjës;
 - 1.15. Hulumton programe të ndryshme të asistencës së BE-së, që ofrojnë mbështetje për qeverisje dhe zhvillim lokal;
 - 1.16. Harton Planin Lokal të Turizmit dhe përgjegjësit për zbatimin e tij;
 - 1.17. Harton strategjinë e zhvillimit të turizmit dhe planin e veprimit;
 - 1.18. Krijon dhe menaxhon regjistrin lokal të turizmit dhe regjistrin lokal të burimeve turistike;
 - 1.19. Harton politikat e zhvillimit të produktit turistik dhe marketingut në fushën e turizmit, bazuar në Strategjinë e Zhvillimit të Turizmit;
 - 1.20. Harton programe për mbështetjen e projekteve turistike veçanërisht në Shalë të Bajgorës;

1.21. Koordinon procesin e Integrimit Evropian;

1.22. Koordinimin e procesit të zhvillimit të kornizës rregullative dhe të politikave të Komunës që ndërlidhen me procesin e integrimit evropian dhe që dalin nga dokumente strategjike, si ato nacionale ashtu edhe ato lokale, të këtij procesi, përfshirë pjesëmarrjen në caktimin e prioriteteve komunale në këtë aspekt dhe koordinimin e realizimit të obligimeve të Komunës që dalin nga marrëdhëniet Kosovë-BE;

1.23. Pjesëmarrjen në caktimin e prioriteteve komunale dhe zhvillimit të kornizës rregullative dhe të politikave nga ana e Drejtorive sektoriale, me qëllim të reflektimit të obligimeve përkatëse në lidhje me integrimin evropian në kuadër të secilit sektor;

1.24. Monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e rregullt të implementimit të këtyre dokumenteve strategjike dhe prioriteteve komunale te kryetari i Komunës dhe autoritetet qendrore, përmes Ministrisë Përgjegjëse për Qeverisje Lokale;

1.25. Koordinimin e asistencës së BE-së dhe asistencës tjetër të jashtme;

1.26. Koordinimin dhe pjesëmarrjen në zhvillimin dhe implementimin e politikave dhe strategjive me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve të komunave për të kryer më sukses të gjitha reformat e nevojshme, përfshirë monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e rregullt të implementimit të tyre;

Organizimi i Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian

1. Funksionim i Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian do të bazohet në këta sektorë:

1.1. Sektori i Ekonomisë dhe Turizmit

1.1.1. Qendra Komunale e Biznesit

1.2. Sektori i Zhvillimit

1.3. Sektori i Integriteteve Evropiane

Sektori i Ekonomisë dhe Turizmit

1. Sektori i Ekonomisë dhe Turizmit kryen këto detyra dhe është përgjegjëse për:
 - 1.1. Monitoron dhe harton raporte të rregullta periodike mbi zbatimin e dokumenteve të politikave dhe strategjive;
 - 1.2. Bashkëpunon me ministritë e linjës për përcaktimin e treguesve kryesorë të buxhetit të shtetit dhe përparësitë e investimeve publike;
 - 1.3. Ofron mbështetje në organizimin e evenimenteve publike lidhura me zhvillimin ekonomik në Komunën e Mitrovicës së Jugut;
 - 1.4. Përgatitë dhe përditëson, në koordinim me ministritë dhe institucionet përkatëse, bazën e të dhënave për zhvillimin ekonomik në Komunën e Mitrovicës Jugore;
 - 1.5. Përgatitë periodikisht dhe publikon analiza të treguesve ekonomikë për zhvillim ekonomik lokal e sektorial;
 - 1.6. Investon në zhvillimin e turizmit lokal dhe interesit publik nëpërmjet investimeve vendase apo të huaja;
 - 1.7. Mbështetë veprimtaritë turistike dhe krijon kushte të favorshme ekonomike dhe strukturore për zhvillimin e tyre;
 - 1.8. Angazhohet në zhvillimin dhe mbështetjen e turizmit pritës;
 - 1.9. Mbështetë dhe bashkëpunon me grupet e interesit në procesin e studimit të tregut, lidhur me burimet dhe produktet turistike, zhvillimin e tyre në përputhje me kërkesat e tregut turistik dhe konkurrencën në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit;
 - 1.10. Mbështetë, mbron e zhvillon burimet turistike dhe promovon produktet turistike, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit dhe në bashkëpunim me grupet e interesit;
 - 1.11. Angazhohet për mbarëvajtjen, mbrojtjen dhe nxitjen e punësimit në industrinë e turizmit, duke i dhënë prioritet punësimit të rinjve;
 - 1.12. Nxitë, mbështetë dhe promovon edukimin dhe formimin profesional të vazhdueshëm turistik, nëpërmjet institucioneve dhe programeve të akredituara, sipas legjislacionit në fuqi, në bashkëpunim me ministritë përgjegjëse që mbulojnë fushën përkatëse;
 - 1.13. Nxitë, mbështetë dhe bashkëpunon me institucione publike dhe private në mbledhjen, përpunimin dhe administrimin e të dhënave në fushën e turizmit;
 - 1.14. Bashkërendon punën për zbatimin e dispozitave ligjore, përfshirë konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e turizmit.
 - 1.15. Bashkëpunon me organizata ndërkombëtare që veprojnë në fushën e turizmit për programet e asistencës që ato ofrojnë;
 - 1.16. Bashkëpunon me autoritetet kompetente për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e vizitorëve vendas apo të huaj;
 - 1.17. Përcakton kriteret për funksionimin e zyrave të informacionit turistik;
 - 1.18. Bashkërendon punën me institucionet përgjegjëse për pajisjen e infrastrukturës rrugore dhe inxhinierike me sinjalistikën turistike, mbrojtjen e integruar të mjedisit, mbrojtjen nga ndërhyrjet e paligjshme dhe dëmtimet në zonat turistike;
 - 1.19. Administron çdo ankesë të shtetasve, vendas apo të huaj, ndaj hotelierëve, pronarëve të resorteve turistike, udhërrëfyesve turistikë, agjencive të udhëtimit, operatorëve turistikë dhe sipërmarrjeve të tjera turistike për shërbimet e ofruara, dhe ia përcjell për shqyrtim inspektoratit që mbron fushën e turizmit;

- 1.20. Mbështetë, nxitë dhe ndërgjegjëson sipërmarrjet turistike, që ushtrojnë veprimtari turistike si strukturë akomoduese, lidhur me përdorimin me efikasitet të burimeve natyrore.
2. Në kuadër të Sektorit të Ekonomisë dhe Turizmit funksionon Qendra Komunale e Biznesit e cila kryen këto detyra dhe është përgjegjëse për:
 - 2.1. Regjistrimin e bizneseve, klasifikimin sipas veprimtarive, identifikimi i bizneseve aktive dhe pasive;
 - 2.2. Pranimi dhe trajtimi i kërkesave për ndryshim të emrit, për ndryshim të adresës, për ndryshim të tipit, për ndryshim të numrit të punëtorëve, për ndryshim të aktivitetit, për ndryshim të pronarëve, për ndryshim të bordit, për ndryshim të kapitalit, për çregjistrim, për ndryshim përfaqësuesi/drejtori, për informata, për certifikatë dublikat, etj;
 - 2.3. Përgatitjen e raporteve periodike dhe informatave për punën e Qendrave Komunale të Bizneseve;
 - 2.4. Mirëmbajtja e shënimeve ditore (siç parashihet me Manualin operacional) në lidhje me ndonjë shkëmbim të dokumenteve dhe informatave me palët dhe të dhënat e tilla do të jenë në dispozicion në të gjithë kohën për nevojat e Komunës;
 - 2.5. Ruajtja dhe mirëmbajtja e dokumenteve origjinale dhe fletëpagesave të dorëzuara nga palët, në pajtim me ligjet dhe aktet e tjera në fuqi.

Sektori i Zhvillimit

1. Sektori i Zhvillimit kryen këto detyra dhe është përgjegjëse për:
 - 1.1. Propozon, harton dhe siguron zbatimin e dokumenteve të politikave/strategjive në fushën e zhvillimit Ekonomik dhe bashkërendon procesin e konsultimeve me akterët relevantë;
 - 1.2. Bashkëpunon me organet tjera komunale me qëllim të informimit për plane zhvillimore dhe tërheqjen e investimeve;
 - 1.3. Hartimin e planit për shfrytëzimin e burimeve ekonomike që janë brenda Komunës;
 - 1.4. Identifikon fonde nga burime të ndryshme për realizimin e projekteve;
 - 1.5. Bën analiza që shërbejnë si bazë për planet zhvillimore;
 - 1.6. Cakton dhe propozon prioritetet e zhvillimit në fusha të ndryshme;
 - 1.7. Organizon ekupe të ekspertëve të ndryshëm për hartim të planit të zhvillimit ekonomik në nivel komune dhe hartimin e projekteve kapitale për përfitim të donacioneve;
 - 1.8. Harton strategjinë e zhvillimit të përgjithshëm afatmesëm dhe afatgjatë për Komunën;
 - 1.9. Bashkëpunon me organet relevante në nivelin lokal dhe atë qendror për tërheqje të investimeve;
 - 1.10. Bashkëpunon me ekspertë të fushave të ndryshme që ofrojnë përvoja të ndryshme në zhvillim;
 - 1.11. Merr pjesë në seminare – promovime të karakterit zhvillimor;
 - 1.12. Kryen edhe punët tjera në fushën e zhvillimit lokal.

Sektorit i Integritimeve Evropiane

1. Sektori i Integritimeve Evropiane kryen këto detyra dhe është përgjegjëse për:
 - 1.1. Ofron mbështetje, këshilla dhe ekspertizë profesionale kryetarit të Komunës dhe drejtorive komunale në përcaktimin dhe vendosjen e prioritetëve të Komunës në fushën e

integrimit evropian, duke marrë parasysh dhe me qëllim të kryerjes së obligimeve që dalin për Komunën nga të gjitha dokumentet strategjike nacionale për integrim evropian dhe marrëdhëniet Kosovë-BE;

1.2. Koordinohet ngushtë me kryetarin e Komunës, kryesuesin e Kuvendit Komunal dhe drejtorët e drejtorive, si dhe me të gjitha strukturat e tjera vendimmarrëse komunale, në zhvillimin dhe avancimin e kornizës rregullative dhe të politikave të Komunës;

1.3. Koordinohet ngushtë me kryetarin e Komunës, kryesuesin e Kuvendit Komunal dhe drejtorët e drejtorive, si dhe me të gjitha strukturat e tjera vendimmarrëse komunale, në hartimin e planit vjetor të Komunës, me qëllim të reflektimit të prioritetëve dhe objektivëve që përmbajnë dokumentet strategjike komunale, duke marrë parasysh dhe me qëllim të kryerjes së obligimeve që dalin për Komunën nga të gjitha dokumentet strategjike nacionale për integrim evropian dhe marrëdhëniet Kosovë-BE;

1.4. Koordinohet dhe konsultohet ngushtë me ministrinë përgjegjëse për qeverisje lokale dhe me Ministrinë e Integrimit Evropian, me qëllim të sigurimit të harmonizimit të prioritetëve dhe politikave të Komunës me kornizën nacionale legjislative dhe të politikave për vetëqeverisje lokale dhe për integrim evropian, si dhe me qëllim të reflektimit të dokumenteve strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vetëqeverisje lokale dhe integrim evropian;

1.5. Koordinohet dhe konsultohet ngushtë me strukturat udhëheqëse komunale (Kryetari i Komunës, kryesuesi i Kuvendit Komunal, drejtorët e drejtorive dhe strukturat e tjera relevante komunale) dhe me strukturat qendrore (ministrinë Përgjegjëse për qeverisje lokale dhe atë të Integrimit Evropian) për të siguruar pajtueshmërinë e kornizës rregullative dhe të politikave komunale me standardet e BE-së;

1.6. Merr pjesë në përcaktimin dhe planifikimin e aktiviteteve të Komunës në kuadër të dokumenteve strategjike nacionale për integrim evropian, në koordinim dhe bashkëpunim të ngushtë me ministrinë përgjegjëse për qeverisje lokale dhe Ministrinë e Integritimeve Evropiane;

1.7. Bën monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e rregullt të implementimit të prioritetëve dhe dokumenteve strategjike të Komunës, si dhe të aktiviteteve relevante në kuadër të dokumenteve strategjike nacionale për integrim evropian dhe obligimeve të Komunës që dalin nga marrëdhëniet Kosovë-BE;

1.8. Koordinohet dhe bashkëpunon ngushtë me ministrinë përgjegjëse për qeverisje lokale dhe Ministrinë e Integrimit Evropian, për të siguruar reflektimin e sfidave, nevojave, prioritetëve, si dhe raportimin e arritjeve të Komunës në punën e rregullt të strukturave koordinuese Ndër-Institucionale për Integrim Evropian;

1.9. Koordinon, në bashkëpunim të ngushtë me ministrinë përgjegjëse për qeverisje lokale dhe atë të Integrimit Evropian, programimin dhe implementimin e asistencës së BE-së dhe të asistencës nga burime të tjera të jashtme (bilaterale dhe multilaterale), në kuadër të Komunës;

1.10. Ofron mbështetje dhe këshilla shërbimeve juridike të Komunës dhe Komisioneve të Kuvendit Komunal me qëllim të reflektimit të Acquis-së dhe politikave përkatëse të BE-së në zhvillimin e kornizës rregullative të Komunës, si dhe kujdeset që reforma e kornizës rregullative komunale të reflektohet në punën e ekzekutivit dhe legjislativit të Komunës;

1.11. Koordinohet dhe bashkëpunon me Zyrën e Personelit në Komunë për ngritjen e kapaciteteve të stafit në çështjet që lidhen me integrimin evropian.

1.12. Koordinohet dhe bashkëpunon ngushtë me Zyrën për Komunikim dhe Informim me Publikun në Komunë për çështjet e komunikimit dhe informimit që kanë të bëjnë me integrimin evropian;

1.13. Ndërmerr të gjitha veprimet tjera të kërkuara nga kryetari i Komunës që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrës;

1.14. Në përmbushjen e detyrave Zyra bashkërendon punën në mënyrë të rregullt me Ministrinë e Integrimit Evropian, ministrinë përgjegjëse për qeverisje lokale, Ministrinë e Financave dhe institucionet tjera përkatëse.


Realizimi i objektivave dhe aktiviteteve

Në vitin 2022-2024, Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm është angazhuar në krijimi e një ambienti të favorshëm i të bërit biznes dhe në fuqizimin e mekanizmave për zhvillimin ekonomik lokal si dhe në zhvillimin e turizmit lokal.

Objektivi 1: Fuqizimi i rolit të komunës në zhvillimin ekonomik dhe zhvillimin e turizmit

Fuqizimi i Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm: Kemi fuqizuar rolin e drejtorisë së re e cila ka në fokus zhvillimin ekonomik dhe turizmin në Mitrovicë si një ndër prioritetet tona të qeverisjes. Themelimi i këtij dikasteri është hapi i parë përmes të cilit do të ju ofrohen kushte të favorshme për investime, mbështetje më të madhe për bizneset fillestare dhe projektet innovative (ekonomia digjitale), promovimin e kompanive dhe prodhimeve vendore etj.

Ballkoni Panoramik i qytetit dhe shtegu i ecjes - Kemi përfunduar ndërtimin e projektit kapital Ballkoni Panoramik i qytetit dhe Shtegu i ecjes në vlerë 250,000.00€, projekt ky është kthyer në një atraksion në vete për fuqizimin e turizmit por edhe rekreacion për banoret dhe qytetaret. Projekti ka një shteg ecje malore prej 1.1km dhe një pikë vëzhgimi panoramike nga ku shihet i gjithë qyteti i Mitrovicës.



Shtegu i ecjes deri tek shkronjat e arta të UCK-së: Kemi filluar hapjen e shtegut të ri prej 2.6km nga Ballkoni Panoramik deri tek shkronjat e arta të UCK-së, projekt ky i cili zgjeron shtigjet e ecjes në qytetin e Mitrovicës si dhe ndikon në promovimin dhe fuqizimin e turizmit në Mitrovicë.



130 praktikantë me pagesë në institucione publike: Në vitin 2024 kemi nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me UNICEF në kuadër të projektit Generation Unlimited përmes të



cilit kemi angazhuar 130 praktikantë me pagesë në institucionet publike të Komunës së Mitrovicës. Kjo iniciativë ishte e para e këtij lloji në këto përmasa përmes së cilës kemi synuar të ju ofrojmë të rinjve përvojat institucionale për zhvillimet e tyre personal dhe profesional.

Organizimi i trajnimeve profesionale falas për të rinjë - Në vitin 2024 në bashkëpunim me donatorët janë certifikuar të rinjë për orientim në karrierë, në hartimin e planit të bizneseve dhe trajnime tjera profesionale. Përfitues nga të gjitha trajnimet janë rreth 150 të rinjë, gra dhe vajza.



Realizimi i projektit të hulajës për personat me nevojë të veçanta - Në kuadër të fuqizimit dhe përkrahje për të gjitha kategoritë e shoqërisë kemi realizuar edhe projektin unik dhe shumë të veçantë duke vendosur hulajën për personat me nevojë të veçanta. Projekte të tilla përpos rëndësisë që kanë ato në vetë përmbajnë edhe pjesën lobimit për të punuar bashkë që këtë pjesë të shoqërisë ti bëjmë pjesë të përditshmërisë dhe jetës shoqërore.

Objektivi 2: Promovimi i bizneseve dhe vendeve të punës


Pjesëmarrja në panairë brenda dhe jashtë vendit: Në bashkëpunim me bizneset gjatë gjithë vitit kemi pasur të hapur skemën e subvencionimit të bizneseve për pjesëmarrje në panairë brenda dhe jashtë vendit. Skema nga ky vite do të jetë e hapur gjithmonë gjatë gjithë periudhave të vitit.

Lansimi i skemës Trajnim / Praktikë në punë me pagesë për personat me nevoja të veçanta Ne vitin 2024 kemi lansuar skemën e trajnimit dhe praktikës në punë me pagesë për 10 përfitues nga kategorie e personave me nevoja të veçanta.




Objektivi 3: Promovimi dhe fuqizim i turizmit lokal

Thirrja publike për OJQ në fushën e turizmit: Në vitin 2024 kemi përkrahur 12 organizata joqeveritare me projekte të turizmit me vlerë total prej 75,000.00 Euro. Përmes kësaj thirrje kemi realizuar shumë projekte në hapësira publike duke promovuar atraksionet si dhe zhvilluar atraksione të reja siç janë, markimi i shtigjeve të ecjes, vendosja e instalacioneve turistike, promovimi i pikave turistike dhe shumë projekte në hapësira publike etj.



Shtegu malor i ecjes Selac - Maja e mprehtë: Në vitin 2024 së bashku me OJQ TEK kemi hapur, markuar dhe shenjëzuar në platformat ndërkombëtare shtegun e ecjes nga Selaci deri tek Maja e mprehtë me gjatësi 8.3km. Ky shteg është shtegu i parë në Mitrovicë i cili edhe zyrtarisht ka marrë kodin unik të shtigjeve dhe është i njohur ndërkombëtarisht si shteg për të gjithë dashamirët e ecjes në natyrë.

Superheronjtë në Mitrovicë: Në vitin 2024 së bashku me Klubin Alpin Prishtina për herë të parë në Mitrovicë kemi realizuar aktivitetin e lëshimit alpin ‘Superheronjtë në Mitrovicë’, ky aktivitet rekreativ ka qene një aktivitet unik dhe shumë i pëlqyer qe ka ngjallur kureshtje dhe shumë pasion tek fëmijët.



Shatërvanët tek liqeni në Mitrovicë: Gjate vitit 2024 kemi lëshuar në punë dy shatërvan tek liqeni artificial të cilët janë një atraksion unik dhe te cilët i jepin gjallëri asaj pjese të qytetit.



Objektivi 4: Ofrimi i përkrahjes për biznese fillestare dhe atyre ekzistuese

Mbështetje për Start-UP biznese: Viti 2024 kemi vazhduar bashkëpunimit tonë me institucionet e ndryshme, donatorët si dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare për të shprehur planet, gatishmërinë dhe nevojën e zhvillimit ekonomik të qytetit tonë. Në vitin 2024 kemi shpërndarë 10 grante për bizneset e udhëhequra nga gratë, vajzat dhe të rinjtë dhe kemi përkrahur shumë të tjera në orientim dhe këshillim.





Marrëveshja me organizatën INTEGRA: Në vitin 2024 kemi vazhduar me bashkëpunime me organizatën Integra përmes së cilës në vitin 2023-2025 do të kemi bashkëpunim në shumë fusha. Pas themelimit të QAK (Qendrën për Angazhim të Komunitetit) e cila është rinovuar në tersi dhe inventarizuar, ku janë mbajtur rreth 40 aktivitete.

Informata dhe përkrahje për bizneset: Përmes qendrës për regjistrim të bizneseve kemi ofruar përkrahje profesional në regjistrimin e bizneseve të reja dhe kemi ofruar shërbime në ndryshimin e të dhënave të bizneseve dhe kërkesave për shuarje.

Objektivi 5: Funkcionalizimi i zonave ekonomike dhe ofrimi i kushteve të bërit biznes

Nënshkrimi i 14 kontratave me bizneset për tu bere pjese e Zonës Ekonomike - Me vendim të kuvendit komunal kemi nënshkruar kontratat me bizneset përfituese për ndarjen e 14 parcelave për bizneset prodhuese, përpunuese dhe shërbyese, me qëllim të zhvillimit ekonomik dhe rritje së punësimit.



Pronat komunale: Jemi përballur dhe po përballemi me mangësi të pronave komunale për të realizuar projektet tona për zhvillim ekonomik dhe turizëm. Gjatë vitit 2022-2024 kemi filluar bashkëpunimin tonë me Agjencinë e Privatizimit të Kosovës për të kthyer në pronë komunale të gjitha asetet e ndërmarrjeve shoqërore të cilat janë të vendosura në prona komunale për të mundësuar shfrytëzimin e parcelave. Po ashtu kemi analizuar të gjitha lokacionet dhe kemi përgatitur planet tona për realizimin e parkingjeve në qytet.